

“Koha e duhur për investime që rritin eficientësinë”

Kërkesa për kredi për instalimin e impianteve fotovoltaike nga bizneset, shënoi rritje të shpejtë në pjesën e dytë të vitit të shkuar dhe trendi po mbetet i njëjtë edhe këtë vit. Loreta Gogaj, Drejtore e Departamentit të Biznesit SME, në Union Bank, thotë se ky efekt ishte i lidhur direkt me krizën e energjisë. Nga ana tjetër, znj. Gogaj nënvizon se kreditë e gjelbra janë një tjetër formë financimi e disponueshme prej disa vitesh, si për bizneset, edhe për individët, duke mbështetur projekte të eficientës. Ofrimi i skemave nxitëse nga sektori publik, por edhe institucionet partnere ndërkombëtare, vlerësohet se mund t'i jepte një tjetër shtysë rritjes së investimeve të kësaj natyre.



LORETA GOGAJ

Drejtoreshë e Departamentit të Biznesit SME, Union Bank

A ofron banka juaj financim të dedikuar për eficientësinë e energjisë. Mund të kemi disa detaje më shumë mbi produktin?

Union Bank ka si qëllim primar shërbimin ndaj klientit, prandaj përpigëmi gjithmonë të zhvillojmë dhe ofrojmë produkte të thjeshta kreditore, që përshtaten dhe plotësojnë nevojat e bizneseve. Në kushtet kur eficientia e proceseve dhe cilësia e produkteve është mjaft e rëndësishme për bizneset dhe investimet në këtë drejtim janë bërë të domosdoshme, Union Bank ka krijuar produkte që financojnë këto investime.

Union Bank ka një spektër të gjerë në drejtim të financimeve me kredi të gjelbra, si për bizneset, edhe për individët. Prej disa vitesh, ne jemi aktivë në financimin e klientëve individë, nëpërmjet Kredisë Kursim Plus GEF, nëpërmjet së cilës klientët marrin kthim të investimit deri në 20%, nëse investojnë në pajisje apo materiale për banesën e tyre, të cilat përbushin kushtet e eficientës së energjisë. Gjithashtu financojmë edhe

biznese që tregojnë materiale që sjellin eficientësi të energjisë. Një vend të rëndësishëm në portofolin e kredive të gjelbra zënë edhe investimet në energjinë e rinovueshme. Këtë vit, po marrin fokus të madh investimet në sistemet fotovoltaike.

A është një produkt i dedikuar për bizneset apo për individë?

Kredia për panelet fotovoltaike është një produkt i dedikuar për bizneset për përdorim në funksion të aktivitetit të biznesit. Ky është një produkt i thjeshtë, që bazohet në kostot e faturave të energjisë, të cilat synohet të zëvendësohen me këstet e kredisë që merret për këtë investim. Për një periudhë rreth 4-vjeçare, biznesi do të zëvendësojë pagesën e faturës aktuale të energjisë me këstin e kredisë. Pas

kësaj, përfiton një investim afatgjatë në kompaninë e tij, i cili redukton ose eliminon tërësisht kostot e energjisë elektrike.

Si është interesi për këtë lloj produkti dhe cilat janë arsytet që ka ende pak vëmendje ndaj eficientësisë së energjisë?

Vitin e fundit, presioni i rritjes së çmimit të energjisë elektrike, si dhe miratimet e akteve nënligjore, kanë aktivizuar kompanitë që ofrojnë këto produkte eficientë dhe kanë shtuar interesin e bizneseve për të bërë investime në drejtim të energjisë së rinovueshme. Interesimi u ndje edhe në kërkesën për kredinë e paneleve fotovoltaike. Besojmë se kërkesa do të vijë duke u rritur, pasi edhe kredia e ofruar është e thjeshtë dhe me kushte të favorshme për bizneset dhe investimi është me vlerë afatgjatë për bizneset.

Nga vlerësimet tuaja, sa kohë duhet për të kthyer investimin, sigurisht duke u bazuar në projekte konkrete që ju keni mbështetur?

Në bazë të përlllogaritjeve nga ekspertët, kthyeshmëria nga këto investime mund të përfitohet pas rreth 4-5 viteve. Kjo mund të ndryshojë në varësi edhe të elementeve teknike të investimit të realizuar. Në këtë linjë shkon edhe afati i kredisë së ofruar.

Si mund të nxitet tregu për t'u orientuar drejt eficientësisë, si nga sektori publik, edhe ai privat?

Ka disa mënyra apo masa që mund të nxisin këto investime: rregullimi dhe miratimi i marrëveshjeve për prodhimin e energjisë, kundrejt konsumit nga ana e biznesit, për një periudhë më afatgjatë, ofrimi i fondeve të garancive sovraane, apo stimuj të tjerë që mund të ofrohen nga sektori publik në drejtim të përjashtimeve nga taksat, etj. Një rol të rëndësishëm luajnë edhe organizatat apo institucionet partnere të huaja, të mbështetura nga Bashkimi Europian nëpërmjet skemave incitivuese apo fondeve të garancive, që ofrojnë për sistemin bankar. Mbështetja me produkte të thjeshta dhe të shpejta të ofruara nga bankat, shoqëruar dhe me një këshillim financiar, do të ndihmojë në rritjen e investimeve në këtë drejtim. ■

VITIN E FUNDIT

Presioni i rritjes së çmimit të energjisë elektrike, si dhe miratimet e akteve nënligjore, kanë aktivizuar kompanitë që ofrojnë këto produkte eficientë dhe kanë shtuar interesin e bizneseve për të bërë investime në drejtim të energjisë së rinovueshme.

PANELET FOTOVOLTAIKE

INVESTO NJËHERË DHE KURSE PËRHERË

